

TË DHËNA PËR FLORËN DHE BIMËSINË E SHPATIT JUGOR TË VARGUT MALOR LENIJE – VALAMARË

MERSINLLARI M.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

Përmbledhje

Në artikull jepen të dhëna të përgjithshme për florën dhe bimësinë e faqes jugore të vargut Lenije-Valamarë. Jepen të dhëna për vlerat florike-shkencore, me mjaft lloje të rralla e tipike, të tilla si *Fstucopsis serpentini*, *Minuartia velenovski*, *Viola ducadjinica* etj. Tregohet gjithashtu një larmi e shoqërimeve bimore (5 asociacione e grupime), që iu përkasin disa njësive e grupimeve fitosociologjike. Bie në sy dominimi i bishtpelëzës (*Festuca* sp. div.) dhe i mjaft leguminozeve që dëshmojnë për vlera të mira kullimore.

Abstract

The paper provides general information about the flora and vegetation of the southern slopes of Lenije-Valamarë area (ose ridge). It is particularly focused on values of many rare species, typical for this area, such as *Fstucopsis serpentini*, *Minuartia velenovski*, *Viola ducadjinica* ect. It is also described a variety of plant communities characteristic of the zone,. Very typical for the area are the communities of *Festuca* sp.div. and same Leguminosae which indicate good value vegetation and pasture.

Fjalëkyçe: Lenije, Valamarë, florë, festuca, shoqërime bimore, klasifikim fitosociologjik.

Hyrje

Në kuadrin e studimeve floristike dhe vegetacionale për pellgun e Korçës, janë bërë një sërë rievimesh në disa nga masivet kryesore të Shqipërisë Juglindore. Ndër to është dhe vargu malor i Valamarës, i cili shërben edhe si kufi ndarës midis një sërë krahinash si ajo e Gorë-Oparit, e Gramshit, e Tomoricës dhe Mokrës. Duke marrë në konsideratë një sërë vlerash të rëndësishme shkencore dhe praktike të bimësisë së faqes juglindore të këtij masivi, po përpiqem të jap disa rezultate të kësaj pune.

Duhet marrë në konsideratë që grumbullimi i të dhënave (rievimet) janë përqëndruar në pjesën më pak të shkelur nga njeriu, si është ajo e zonës paraalpine dhe alpine të shpatit, duke ditur se aty janë përqëndruar më tepër elementet bimore më natyrore dhe më pak të cënuara nga ndërhyrja e njeriut. Por duhet përmendur që janë bërë rievime dhe në pyjore e shkurre të kësaj faqeje.


Analiza përfshin aspektin florik, ku dalin disa elemente me vlerë si pasuria llojore, origjina e tyre, shkalla e rrezikshmërisë, vlerat ekonomike etj., aspektin

vegjetacional, ku evidentohen disa grupime vegjetacionale me vlera, që dëshmojnë edhe për variacione të shumta klimatike-tokësore.

Të dhëna gjeografike, gjeomorfologjike dhe klimatike

Figura 1. Pozita gjeografike e Valamarës.

Ky vargmal përfshihet në ndarjen klimatike të Zonës Mesdhetare malore, nënzona malore juglindore. Kjo nënzonë karakterizohet nga dimra të ftohtë dhe vera të freskëta. Temperaturat mesatare vjetore lëkundën nga 7-10° C. Minimumet absolute arrijnë në -15-18° C. Temperatura mesatare e gushtit lëkundet midis 16-18° C.



Ky vargmal, që shtrihet nga Jug-Lindja në Veri-Perëndim, prej grykës së Gopeshit deri në Qafën e Panjës, ka shpate relativisht të buta në të dy kundrejtimet kryesore (Veri-Perëndimore dhe Jug-Lindore). Kreshta e vargut, kryesisht e mprehtë dhe me përbërje gëlqerore, vazhdon në disa vende me formacione ultrabazike e flishe. Në pjesët më të poshtme të faqeve malore, shtrihen një sërë fshatrash me veprimtaritë e tyre ekonomike kryesisht bujqësore e blegtorale, të

cilat janë të lidhura me pasuritë floristike e bimore të këtyre shpateve.

Vargmali i Valamarës bën pjesë në Krahinën Malore Qëndrore, në Malet midis luginës së Shkumbinit dhe luginës së Devollit. Ky masiv përfshin Malin e Valamarës dhe atë të Lenijes (Kabo *et. al.*, 1991).

Kjo nënzonë ka pak rreshje. Mesatarja vjetore e tyre arrin 900-1200 mm, kur në shpatet perëndimore të maleve kjo shifër rritet. Në periudhën e verës bien shumë pak rreshje. Numuri i ditëve me rreshje shkon rreth 100-110 ditë. Bora fillon nga fillimi i dhjetorit dhe ndërpritet në prill. Pjesa tjetër është periudhë vegjetacioni. (Hidmet, 1975).

Punimet dhe të dhënat botanike për këtë zonë janë të pakta.

Materiali dhe metodat

Gjatë viteve 1990-2000 kemi grumbulluar të dhëna për florën dhe bimësinë e rajonit të Korçës. Janë bërë rievime në popullata të ndryshme bimore, midis të cilave edhe në ato të Vargut Lenije – Valamarë, në vitet 1990-1991. Është grumbulluar dhe listuar flora e popullatave sipas metodikave tashmë të njohura,

kryesisht ajo e kullotave paramalore dhe malore. (Rodwell *et al*, 2002 dhe Horvat *et al* 1974). Për rilevimet është praktikuar metoda e marshrutit, duke mbajtur shënimet e mundëshme të terrenit, marrjen e mostrave të herbarit për speciet ose taksonet e veçanta dhe të dyshimta dhe të dhëna të tjera të rastit. Sipërfaqet provë janë marrë nga 50 deri 100 m²; për bimësinë pyjore dhe 1 dhe 10 m²; për atë barishtore, duke bërë jo më pak se 3-5 të tilla për çdo ndryshim të dukshëm floristik. Vlerësimi i pranise në tabela është bërë sipas Pignatti S. Përpunimi i të dhënave është bërë sipas metodës Braun-Blanquet etj. Tabela analitike dhe ajo sinoptike është hartuar në bazë të krahasimeve dhe përpunimit llogjik të të gjithë të dhënave të grumbulluara nga terreni. Përcaktimi është bërë sipas Papparisto *et.al.*, (1988-2000), Demiri, (1983), Vangjeli, (2003), Tutin *et.al* (1964-1980) etj.

Rezultatet e diskutime

Shtrirja e vargut Lenije-Valamarë është afërsisht P-L. Shpati i rilevuar është ai Jugori, që fillon nga Qafa e Mesmalit në lindje në atë të Dobërçanit në perëndim. Pjesa fundore e malit ecën përgjatë lumit Devoll, nga gryka e Dobërçanit deri te Ura e Verbës, dhe pastaj ndjek rrjedhën e lumit të Selcës deri në Mesmal.

Flora Vargmali dallohet për larmi floristike, për arësye të disa faktorëve që ndikojnë si ndryshimet e shkëmbit amnor, kundrejtimet e shpateve, orografia e tokës, lartësia mbi sipërfaqen e detit, kushtet klimatike, ndikimi i njeriut etj. Lista floristike që kemi regjistruar ka një sërë të dhënash për florën e këtij shpati malor, megjithëse mbetet prapë mjaft e kufizuar. Pasuria floristike e Vargut Lenije-Valamarë, sipas regjistrimeve tona përbëhet nga rreth 84 specieve, ndër të cilat elementet ballkanike dhe subballkanike janë rreth 11 specie si *Festuca pançiziana*, *Dianthus minutiflorus* etj, 6 specie subendemike si *Bornmuelleria baldacci*, *Dianthus scardicus*, *Festucopsis serpentini* etj., 1 endemike, *Viola ducadjinica* dhe disa me status kërcënimi natyror si *Minuartia velenovski*, *Biscutella laevigata*, *Crepis hieracioides* etj.

Më poshtë jepen disa të dhëna për spektrat florikë të këtij masivi malor.

Tabela 1. Lista florike e Valamarës

Nr	Emri i bimës	Familja	Forma biologjike	Elementi korologjik	Statusi i rrez.
1	<i>Acinos alpinus</i>	<i>Labiatae</i>	Ch	Seurop	Nt
2	<i>Agrostis capillaris</i>	<i>Poaceae</i>	H	Circumbor	Nt
3	<i>Alopecurus gerardi</i>	<i>Poaceae</i>	H	Med	Nt
4	<i>Alyssum bertoloni</i>	<i>Apiaceae</i>	H	Balkan	LR
5	<i>Antoxanthum odoratum</i>	<i>Poaceae</i>	H	EuAz	Nt
6	<i>Armeria canescens</i>	<i>Plumbaginaceae</i>	H	EuJ	Nt
7	<i>Asperula aristata</i>	<i>Rubiaceae</i>	H	Med	Nt
8	<i>Biscutella laevigata</i>	<i>Apiaceae</i>	H	EuJ	VU


9	<i>Bornmuelleria baldaccii</i>	Apiaceae	Ch	SubEnd	Nt
10	<i>Bromus erectus</i>	Poaceae	H	Paleotemp	Nt
11	<i>Campanula lingulata</i>	Campanulaceae	H	SubBalk	Nt
12	<i>Campanula patula</i>	Campanulaceae	H	EuAz	Nt
13	<i>Campanula persicifolia</i>	Campanulaceae	H	EuAz	Nt
14	<i>Campanula phrygia</i>	Campanulaceae	T	Balk	Nt
15	<i>Campanula scheuszeri</i>	Campanulaceae	H	EuJ	Nt
16	<i>Campanula sp.</i>	Campanulaceae	-	-	Nt
17	<i>Carduus pycnocephalus</i>	Asteraceae	HT	Med-tur	Nt
18	<i>Carex laevis</i>	Cyperaceae	H	EuJL	Nt
19	<i>Carex sp.</i>	Cyperaceae	-	-	Nt
20	<i>Carlina acanthifolia</i>	Asteraceae	H	EuJ	Nt
21	<i>Carum carvi</i>	Umbelliferae	H	EuAz	Nt
22	<i>Centaurea triumphetti</i>	Asteraceae	H	Eu-kaukaz	Nt
23	<i>Crepis hieracioides</i>	Asteraceae	H	Subendem.	VU
24	<i>Cytisus agnipilus</i>	Leguminosae	Ch	SubEnd	Nt
25	<i>Cytisus sp.</i>	Leguminosae	-	-	Nt
26	<i>Daphne oleoides</i>	Thymelaeaceae	NPh	AzQ-Med	Nt
27	<i>Dianthus deltoids</i>	Cariophyllaceae	H	EuAz	Nt
28	<i>Dianthus minutiflorus</i>	Cariophyllaceae	H	Balk	Nt
29	<i>Dianthus scardicus</i>	Cariophyllaceae	H	Subend	Nt
30	<i>Dianthus sylvestris</i>	Cariophyllaceae	H	Med	Nt
31	<i>Dorycnium pentaphyllum</i>	Leguminosae	H\Ch	EuQJ	Nt
32	<i>Draba aizoon</i>	Apiaceae	H	Europ	Nt
33	<i>Edraianthus graminifolius</i>	Campanulaceae	Ch	SubBalk	Nt
34	<i>Festuca bosniaca</i>	Poaceae	H	SubBalk	Nt
35	<i>Festuca panciciana</i>	Poaceae	H	Balk	Nt
36	<i>Festuca violacea</i>	Poaceae	H	Alpine	Nt
37	<i>Festucopsis serpentini</i>	Poaceae	H	subendemike	NE
38	<i>Fumana procumbens.</i>	Cistaceae	CH	Eu. Pontike	Nt
39	<i>Galium boreale</i>	Rubiaceae	H	Circumbor	Nt
40	<i>Geranium cinereum</i>	Geraniaceae	H	SubBalk	Nt
41	<i>Globularia cordifolia</i>	Globulariaceae	Ch	EuQ-J	Nt
42	<i>Gnaphalium lutealbum</i>	Asteraceae	H	Amer.	Nt
43	<i>Hieracium hoppeanum</i>	Asteraceae	H	MedVL	Nt
44	<i>Hieracium pilosella</i>	Asteraceae	H	Eu-kaukaz	Nt
45	<i>Hieracium staticifolia</i>	Asteraceae	H	Alpin.Din.	Nt
46	<i>Hypericum humifusum</i>	Hypericaceae	H	Subkosmop	Nt
47	<i>Juniperus nana</i>	Cupressaceae	Ph	Eumedit	Nt
48	<i>Koeleria splendens</i>	Poaceae	H	Med	Nt
49	<i>Lotus corniculatus</i>	Papilionaceae	T	Stenomedit	Nt
50	<i>Luzula multiflora</i>	Juncaceae	H	Circumbor	Nt
51	<i>Luzula spicata</i>	Juncaceae	T	Eurasi	Nt
52	<i>Minuartia velenovski</i>	Cariophyllaceae	T	SubEndem	R
53	<i>Minuartia verna</i>	Cariophyllaceae	H	EuAz	Nt
54	<i>Muscari neglectum</i>	Liliaceae	G	Eumedit	Nt
55	<i>Nardus stricta</i>	Poaceae	H	Eu-Siber	Nt
56	<i>Omalotheca neglecta</i>	Asteraceae	H	ArktAlp	Nt
57	<i>Onosma arenaria</i>	Boraginaceae	H	AlpinoP	Nt
58	<i>Phyteuma orbiculare</i>	Campanulaceae	H	EuJ	Nt
59	<i>Plantago subulata</i>	Plantaginaceae	Ch	Med	Nt
60	<i>Poa alpina</i>	Poaceae	H	Circumbor	Nt

61	<i>Poa pratensis</i>	Poaceae	H	Circumbor	Nt
62	<i>Potentilla clusiana</i>	Rosaceae	H	Eu-siber	Nt
63	<i>Potentilla crantzii</i>	Rosaceae	H	Eumedit	Nt
64	<i>Primula veris</i>	Primulaceae	H	Med-EuP	Nt
65	<i>Ranunculus brevifolius</i>	Ranunculaceae	H	SubBalk	Nt
66	<i>Ranunculus millefoliatus</i>	Ranunculaceae	H	Med	Nt
67	<i>Sagina subulata</i>	Cariophyllaceae	H	Med-Atlant	Nt
68	<i>Scleranthus annuus</i>	Cariophyllaceae	T	Palotemp	Nt
69	<i>Scleranthus uncinatus</i>	Cariophyllaceae	T	EuMed	Nt
70	<i>Scorzonera purpurea</i>	Asteraceae	H	EuJL-Siber	Nt
71	<i>Sedum hispanicum</i>	Crassulaceae	T	EuJL	Nt
72	<i>Sedum album</i>	Crassulaceae	H	EuMed	Nt
73	<i>Silene viridiflora</i>	Cariophyllaceae	H	EuAz	Nt
74	<i>Stipa pennata</i>	Poaceae	H	SubBalk	Nt
75	<i>Thymus striatus</i>	Labiatae	Ch-H	SubBalk	Nt
76	<i>Trifolium repens</i>	Leguminosae	H	Eu	Nt
77	<i>Trifolium pilczii</i>	Leguminosae	H	Balk	LR
78	<i>Trinia glauca</i>	Umbelliferae	H	EuJ	Nt
79	<i>Vaccinium myrtillus</i>	Ericaceae	Ch	Circumbor	Nt
80	<i>Veratrum lobelianum</i>	Liliaceae	G	EuAz	Nt
81	<i>Verbascum longifolium</i>	Scrophulariaceae	H	Eu-Caucas	Nt
82	<i>Viola ducadjinica</i>	Violaceae	H	Endemike	LR

Spektrat floristikë të florës së Vargmalit të Valamarës

Spektri sistematik. Familjet më të përfaqësuara janë ajo *Poaceae*, *Asteraceae*, *Caryophyllaceae*, *Campanulaceae*, *Leguminosae* etj., që do të thotë që janë familje të mëdha me areal të gjërë ekologjik ose familje që përshtaten me kushtet

klimatike të kësaj zone si familja



Caryophyllaceae, *Apiaceae* e ndonjë tjetër.

Figura 2. Diagrama sistematike




Figura 3. Diagrama biologjike

Spektri biologjik. Flora e këtij vargu malor, siç duket dhe nga diagrama, dominohet dukshëm nga hemikriptofitet si *Alopecurus gerardi*, *Anthoxanthum odoratum* etj.,




Figura 4. Diagrama florike

të shoqëruara nga kamefitet si *Acinos alpinus*, *Bornmuelleria baldacci* etj. dhe terofitet si *Scleranthus annus*, *Lotus corniculatus* etj., të cilat siç dihen janë më rezistente ndaj klimave të ashpra, për hir të sythave të mbrojtur. Numuri i vogël i geofiteve dhe fanerofiteve tregon dominimin e formave barishtore që është karakteristike e kullotave sidomos atyre malore.

Spektri floristik. Diagrama e paraqitur e tregon mjaft qartë që llojet me origjinë mesdhetare si *Ranunculus millefoliatum*, euromesdhetare dhe europiano jugore si *Acinos alpinus*, *Biscutella laevigata*, *Campanula scheuzeri* etj. përbëjnë pjesën më të madhe të përfaqësuesëve të florës së kësaj treve. Elementët më të pakët të kësaj flore janë ato të ardhura nga mjediset arktike, aziatike etj. Prania e elementeve euaziatik dëshmon për format malore të florës, të cilat janë afër me përfaqësuesit e zonave të largëta.

Mbi vlerat ekonomike të florës së Valamarës

Një ndër vlerat më të spikatura të Vargut malor Valamarë janë ato ekonomike. Shumë prej këtyre specieve njihen ose jo nga të gjithë, por kanë vlera mjekësore, kullosose, si të dëmshme për kafshët dhe njeriun, ngjyruese, ushqimore etj. Në përputhje me rëlevimet floristike të bëra në këtë vargmal, përfshi këtu edhe rëlevime në mjedisë pyjore, shkurre dhe përrenj të pjesës së poshtme të shpatit malor, përmendim speciet e mëposhtme:

Rreth 57 specie janë me interes mjekësor si: *Achillea millefolium*, *Aesculus hippocastanum*, *Agrimonium eupatorium*, *artemisia vulgaris* etj. Mbi 14 specie janë të dëmshme për blegtorinë, nga të cilat përmendim: *Verbascum longifolium*, *Carlina acanthifolium*, *Daphne oleoides*, *Helleborus odoratus*, *Colchicum autumnale*, *Veratrum album* etj.

Më shumë se 25 specie të dobishme për kullotje si: *Astragalus glycyphyllos*, *Avena barbata*, *Bromus erectus*, *Festuca elatior*, *Festuca ovina*, *Lathyrus pratensis*, *Lolium multiflorus*, *L. perenne*, *Lotus corniculata*, *Onobrychis vicifolia* etj. Mbi 50 specie mjaltore: *Calamintha grandiflora*, *Centaurea alba*, *Cirsium arvense*, *Crataegus monogyna*, *Cucurbita pepo.*, *Cydonia vulgaris*, *Melilotus albus*, *Melissa officinalis*, *Pyrus communis*, *Robinia pseudoacacia* etj. Në tabelat e mëposhtme jepen më të plota listat e disa prej këtyre kategorive floristike:

Tabela 2. Bimë mjekësore

Emri i bimës
<i>Achillea millefolium</i>

<i>Adiantum capillus – veneris</i> *
<i>Aesculus hippocastanum</i> **
<i>Agrimonia eupatoria</i>

<i>Allium cepa</i>
<i>Allium porrum</i>
<i>Allium sativum</i>

<i>Alnus glutinosa</i> *
<i>Arctium lappa</i> *
<i>Artemisia vulgaris</i> *
<i>Avena sativa</i>
<i>Bellis perrennis</i>
<i>Bidens tripartita</i> *
<i>Brasica oleracea</i>
<i>Capsella bursa-pastoris</i>
<i>Capsicum annum</i>
<i>Castanea sativa</i> **
<i>Centaurea cyanis</i> *
<i>Centaurium erythraea</i> *
<i>Cerasus vulgaris</i>
<i>Ceterach officinarum</i> *
<i>Matricaria chamomilla</i> *
<i>Chelidonium majus</i> *
<i>Chichoria intybus</i>
<i>Cholcicum autumnale</i> **
<i>Consolida regalis</i>
<i>Convolvulus sepium</i> *
<i>Corylus avellana</i>
<i>Craytaegus monogyna</i> *
<i>Cucumis sativa</i>
<i>Cydonia oblonga</i> *
<i>Crataegus oxyacantha</i> *
<i>Cynodon dactylon</i>
<i>Daucus carota</i>
<i>Digitalis lanata</i> *
<i>Eryngium campestre</i>
<i>Equisetum arvense</i>
<i>Fragaria vesca</i>
<i>Fraxinus ornus</i> *
<i>Galega officinalis</i>
<i>Geum urbanum</i>

<i>Hedera helix</i>
<i>Helleborus odoratus</i>
<i>Hieracium pilosella</i>
<i>Hordeum vulgare</i>
<i>Hypericum perforatum</i> *
<i>Juglans regia</i> **
<i>Juniperus communis</i> *
<i>Malva silvestris</i> **
<i>Zea mays</i>
<i>Mentha piperita</i> **
<i>Morus nigra</i> *
<i>Ononis spinosa</i>
<i>Orchis morio</i> **
<i>Origanum vulgare</i>
<i>Papaver rhoeas</i>
<i>Plantago lanceolata</i>
<i>Plantago major</i>
<i>Polygonum aviculare</i> *
<i>Polygonum hidropiper</i> *
<i>Polypodium vulgare</i> **
<i>Primula veris</i> **
<i>Prunus spinosa</i> *
<i>Pulmonaria officinalis</i> *
<i>Rosa canina</i>
<i>Rubus ulmifolius</i>
<i>Rubus idaeus</i> **
<i>Salix purpurea</i> *
<i>Salix alba</i> *
<i>Sambucus ebulus</i>
<i>Sambucus nigra</i> *
<i>Saturea montana</i> **
<i>Sideritis roeseri</i> **
<i>Tanacetum vulgare</i>
<i>Taraxacum officinalis</i>

<i>Teuchrium chamaedrys</i>
<i>Thymus longicaulis</i>
<i>Tilia cordata</i> **
<i>Tussilago farfara</i>
<i>Ulmus campestris</i> *
<i>Urtica dioica</i>
<i>Vaccinium myrtillus</i> **
<i>Verbascum phlomoides</i> *
<i>Verbena officinalis</i>
<i>Viola odorata</i>
<i>Viscum album</i> **

P.S.Shenjat në listën e mësipërme kanë të bëjnë me një vlerë relative të gjendjes së tyre në teritorin në fjalë:

**gjendet në sasira të vogla *gjendet në sasira mesatare; gjendet e zakonëshme

Tabela 3. Bimët e dëmshme

Lista e specieve të dëmshme		
Emri i bimës		
<i>Verbascum longifolium</i>		
<i>Carlina acanthifolia</i>		
<i>Daphne oleoides</i>		
<i>Eryngium campestre</i>		
<i>Helleborus odorus</i>		
<i>Ononis spinosa</i>		
<i>Caltha palustris</i>		
<i>Colchium autumnale</i>		
<i>Hypericum perforatum</i>		
<i>Gentiana lutea</i>		
<i>Sambucus ebulus</i>		
<i>Solanum nigrum</i>		
<i>Vaeratum album</i>		
<i>Veratrum nigrum</i>		

Lista e llojeve foragjere të Valamarës

Tabela 8.
Speciet
mjaltore

<i>Emri i bimës</i>	<i>Emri i bimës</i>
<i>Avena (C) 18/2014</i>	<i>Phelum alpinum</i>
<i>Avena barbata</i>	<i>Phelum pratense</i>
<i>Avena fatua</i>	<i>Poa pratensis</i>
<i>Bromus erectus</i>	<i>Poa trivialis</i>
<i>Dactylis glomerata</i>	<i>Setaria glauca</i>
<i>Festuca elatior</i>	<i>Taraxacum officinalis</i>
<i>Festuca ovina</i>	<i>Trifolium alexandrinum</i>
<i>Festuca rubra</i>	<i>Trifolium alpestre</i>
<i>Lathyrus pratensis</i>	<i>Trifolium medium</i>
<i>Lolium multiflorum</i>	<i>Trifolium pratense</i>
<i>Lolium perenne</i>	<i>Trifolium repens</i>
<i>Lotus corniculatus</i>	<i>Trifolium resupinatum</i>
<i>Onobrychis viciaefolia</i>	<i>Trigonella corniculata</i>

Lista e llojeve mjaltore të Valamarës

<i>Emri i bimës</i>	<i>Emri i bimës</i>
<i>Acer campestre</i>	<i>Knautia arvensis</i>
<i>Aesculus hippocastanum</i>	<i>Linaria vulgaris</i>
<i>Ajuga reptans</i>	<i>Lithospermum purpureo-coeruleum</i>
<i>Prunella vulgaris</i>	<i>Lycopsis arvensis</i>
<i>Calamintha grandiflora</i>	<i>Lythrum salicoria</i>
<i>Carduus nutans</i>	<i>Malva sylvestris</i>
<i>Cardus macrocephalus</i>	<i>Marubium vulgare</i>
<i>Castanea sativa</i>	<i>Medicago sativa</i>
<i>Centaurea alba</i>	<i>Melilotus albus</i>
<i>Cichorium intybus</i>	<i>Melissa officinalis</i>
<i>Cirsium arvense</i>	<i>Mentha pulegium</i>
<i>Crataegus monogyna</i>	<i>Nicotiana tabacum</i>
<i>Cucumis sativus</i>	<i>Origanum vulgare</i>
<i>Cucurbita pepo</i>	<i>Pirus communis</i>
<i>Cydonia vulgaris</i>	<i>Malus domestica</i>
<i>Cynoglossum officinalis</i>	<i>Punica granatum</i>
<i>Dipsacus sylvestris</i>	<i>Robinia pseudoacacia</i>
<i>Echium vulgare</i>	<i>Rubus ulmifolius</i>
<i>Epilobium montanum</i>	<i>Stachys germanica</i>
<i>Eryngium campestre</i>	<i>Teucrium chamaedrys</i>
<i>Hedera helix</i>	<i>Thymus longicaulis</i>

	<i>Inula viscosa</i>		
--	----------------------	--	--

Bimësia

Bimësia e kësaj zone përfshihet në tri zona fitogjeografike, me karakteristikat e mëposhtme specifike për sejcilën prej tyre, sipas Mitrushit (1966), Kabo *et al.* (1991), Papparisto *et al.* (1980-2000), që janë: zona e dushkut, zona e ahut dhe zona e kullotave malore (subalpine dhe alpine). Më poshtë po jepen të dhëna fitosociologjike kryesisht për zonën e kullotave malore.

Aty-këtu në masivet kullosore të këtij brezi hasen edhe shkurre apo shkurrëza të gjinisë *Rosa*, *Daphne*, *Genista* etj. Këto kullota, ndonëse me sipërfaqe jo të madhe, shërbejnë si një bazë e mirë ushqyese për blegtorinë, sidomos gjatë stinës së verës. Dingu, (2004).

Bimësia fillon me zonën fitoklimatike të dushkut, që përfshin pjesën më të populluar me fshatra, dhe që natyrisht është dhe më e prekura nga shfrytëzimet. Më tej shtrihet zona e ahut, e përfaqësuar nga pylli i ahut vende-vende i degraduar e disa herë i zëvendësuar nga pisha e zezë me përzjerje të *Pinus leucodermis* dhe *P. peuce*. Pjesa më e madhe e shpatit të malit përbëhet nga bimësia barishtore e kullotave malore. Orografia e thyer e shpatit krijon kundrejtime të ndryshme, që ndikojnë në larminë e madhe florike. Faktor tjetër që ndikon mbi florën dhe bimësinë është dhe toka dhe shkëmbi amnor me përbërje ultrabazike, që shpesh dominon në shpat. Mjedise specifike dhe me bimësi të ndryshueshme takon dhe në liqenet e vegjël akullnajorë dhe rrjedhat e shumta të burimeve malore. Një tjetër pamje të del mbi majat shkëmbore të malit, me llojet tipike kserofite. Disa nga shoqërimet kryesore bimore të këtij masivi po i përshkruajmë më poshtë sipas rëlevimeve tona.

Mbështetur edhe në Dring *et al.* (2002) dhe Rodwell *et al* (2002), mund të bëjmë një vendosje sintaksonomike të këtyre shoqërimeve:

1) Klasa Festuco-Brometea Br.Bl. et Tx. In Br.Bl. 1949

Rendi Festucetalia vaginatae Soo 1957

Aleanca Festucion bosniacae Horvat 1930

Gr. Festuca bosniaca - Thymus striatus

Gr. Festuca panciciana – Thymus striatus

2) Klasa Juncetea trifidi

Rendi Festucetalia spadiceae

Aleanca **Nardion** strictae

Shoqërimi Nardetum strictae- Festuca sp. div. , Buzo 1990

3) Klasa Erico – Pinetea Horvat 1959

Rendi Erico – Pinetalia Horvat 1959

Aleanca Pinion leucodermis Horvat 1946 (Gl. C. G.3.6)

Shoqërimi Festucopsis – Pinetum leucodermis Vangjeli 1984

4) Klasa Vaccinio – Piceetea Br.Bl. in Br.Bl., Sissingh et Vlieger 1939

Rendi Picetalia excelsae, Pawlowski in Pawlowski, Sokolowski et Wallisch 1928

Aleanca Rodoro – Vaccinion Br.Bl. 1926

Gr. Vaccinium myrtillus-Juniperus nana

Tabela sinoptike

Emri i bimës	a	b	c	d	e	f
<i>Thymus striatus</i>	V	V	V		IV	IV
<i>Armeria canescens</i>	IV	IV	IV			IV
<i>Veratrum lobelianum</i>	IV	IV	IV			
<i>Festuca bosniaca</i>	V	III	III		II	III
<i>Hieracium pilosella</i>	IV	III	III			
<i>Acinos alpinus</i>	IV		IV			
<i>Alyssum bertolonii</i>	IV		IV			
<i>Bornmuellera baldacci</i>	IV		IV		IV	
<i>Dianthus deltoids</i>	IV		IV			
<i>Hypericum humifusum</i>	IV		III			
<i>Scleranthus uncinatus</i>	IV		III			
<i>Cardus pycnocephalus</i>	III	III	III			
<i>Sagina subulata</i>	III		III	III		
<i>Campanula phrygia</i>	III					
<i>Koeleria splendens</i>	III					
<i>Luzula spicata</i>	III		III			III
<i>Minuartia velenovskvi</i>	III		III			
<i>Festuca panciciana</i>		V	III	III		
<i>Potentilla crantzii</i>		IV	I			
<i>Trifolium repens</i>		III	II	III		
<i>Campanula sp.</i>		III				
<i>Carlina acanthifolia</i>		III	II			III
<i>Minuartia verna</i>		III				
<i>Ranunculus brevifolius</i>		III				
<i>Daphne oleoides</i>	III	III	V		IV	duhet
<i>Stipa pennata</i>	II		V		IV	
<i>Edraiant. graminifolius</i>	III		IV			IV
<i>Carex laevis</i>	III		IV			
<i>Alopecurus garardi</i>	I	II	IV	III		
<i>Lotus corniculatus</i>	II		III	III		III
<i>Nardus stricta</i>	II		II	V		II
<i>Campanula scheuszeri</i>		III		IV		
<i>Ranunculus sp.</i>				IV		
<i>Armeria couses</i>				IV		
<i>Poa sp.</i>				IV		
<i>Bromus erectus</i>				III		
<i>Dianthus scardicus</i>				III		
<i>Festuca sp.</i>				III		
<i>Anthoxanthum odoratum</i>	I		III	II		II
<i>Potentilla clusiana</i>				III		
<i>Festucopsis serpentini</i>					IV	

<i>Pinus heldreichii</i>					IV	
<i>Globularia cordifolia</i>			I		IV	
<i>Asperula aristata</i>	II				IV	IV
<i>Sedum hispanicum</i>			III		IV	
<i>Salvia splendens</i>			III			
<i>Dorycn. pentaphyllum</i>					III	
<i>Galium boreale</i>					III	
<i>Onosma arenaria</i>					III	
<i>Vaccinium myrtillus</i>						V
<i>Juniperus com. ssp nana</i>						V
<i>Primula veris</i>						IV
<i>Carum carvi</i>					III	IV
<i>Dianthus minutiflowers</i>		II				III
<i>Alchemilla civis</i>						III
<i>Centaurea triumfettii</i>						III
<i>Trinia glauca</i>			II			III
<i>Geranium cinereum</i>						III
<i>Crepis sp</i>						II
<i>Agrostis capillaris</i>	II		II			
<i>Poa alpina</i>	II		II			
<i>Carex sp</i>		II			II	
<i>Phyteuma orbiculare</i>	II					
<i>Plantago subulata</i>		II				
<i>Camp. persicifolia</i>			II			
<i>Festuca violeacea</i>			II			
<i>Muscari sp</i>			II			
<i>Draba aizoon</i>			II			
<i>Festuca serpentine</i>			II			
<i>Cytisus agnipilus</i>				II		
<i>Sedum sp</i>					II	
<i>Silene viridescens</i>					II	
<i>Dianthus sylvestris</i>					II	
<i>Gnaphal. luteo album</i>						II
<i>Fumana sp</i>	I					
<i>Trifolium pilczii</i>	I					
<i>Viola ducadiinica</i>		I				
<i>Campanula phrygia</i>			I			
<i>Fumana orbiculare</i>			I			
<i>Morina persica</i>	I		I			
<i>Trifolium pilczii</i>			I			
<i>Cytisus sp</i>						I
<i>Hierac. staticifolium</i>						I

a- Festuca bosniaca – Thymus striatus, b- Festuca pancicianae – Thymus striatus, c- Daphne oleoides Thymus striatus, d- Nardus strictae- Festuca sp. div., e- Festucopsis serpentini – Pinus leucodermis, f- V. myrtillus-Juniperus nana.

Tabela sinoptike e tregon mjaft qartë, edhe pse me pak rievime, ndarjen e disa grupimeve bimore, të cilët po i përshkruajmë më poshtë:

Gr. Festuca bosniacae - Thymus striatus

Është takuar në Stanet e Kavajës, në shpatet mjaft të thyera të malit, me tokë relativisht jo shumë të thellë, të tipit livadhlor malor. Shkëmbi amnor i këtyre mjedisëve është kryesisht ultrabazik, kundrejtimi lindor dhe lartësia arrin 2000-2200m.

Grupimi dallohet për katëzimin e bimësisë barishtore: katin më të sipërm e formon *Veratrum album* (shtara) të padiferencuar qartë. Kat të qartë formon më poshtë grupi i gramoreve me gjinitë *Festuca*, *Poa*, *Koeleria*, *Stipa* etj., përzier me *Armeria*, *Dianthus*, *Hypericum*, *Bornmuellera*. Katin më të ulët e përbëjnë *Thymus*, *Hieracium pilosella*, *Acinus* etj. Grupimi dallohet për përbërje të larmishme floristike, me një kortezh mjaft të pasur florik.

Gr. *Festuca panciana* - *Thymus striatus*

Ky grupim është takuar në shpatin perëndimor por në pjesën jugore të Valamarës. Zakonisht preferon vendet poshtë thepave të cveshura shkëmbore, aty ku bimësia gjen tokë dhe kushte për zhvillim. Grupimi nuk dallohet për katëzim të diferencuar mirë dhe as për denduri apo dhe llojshmëri të lartë.

Gr. *Nardus stricta* - *Festuca sp. div.*

Është ndër shoqërimet më të hasur në faqen jugore të Lenijes. Shtrihet mbi vende me toka të varfëra e të tharta, jo gurishtore, me hapësira bosh midis tufave barishtore. Katëzimi shfaqet me format e larta si *Festuca*, *Verbascum*, *Veratrum* dhe më poshtë dominanti *Nardus stricta*, ndërsa në vendet ku ai mungon zëvendësohet nga *Cytisus*, *Lotus*, *Hieracium* etj.

Bie në sy prania e individëve të rrallë të drurëve të pishave (*Pinus leucodermis*), edhe të tharë, që dëshmon për një të kaluar të hershme të një pishnaje të zhvilluar. Kjo pamje takohet që nga Stanet e Kavajës e në perëndim.

Shoqërimi *Festucopsis* – *Pinetum leucodermis* (Vangjeli, 1984).

Shoqërimi takohet në të gjithë shpatin lindor të majës së Valamarës, në lartësitë 2000-2400 m. Interesante është shoqërimi i *Festucopsis serpentini*, si bimë e mjediseve ultrabazike, me *Stipa pennata*, që preferon më tepër gëlqerorët. Të dy këto lloje dalin në tufa të rralla e të shpërndara me mjaft sipërfaqe boshe midis tyre. Kjo e bën shoqërimin të rrallë në lloje dhe në mbulesë. Si pasojë e këtyre kushteve, si dhe e terrenit të thyer, nuk dallohet dhe katëzimi i tij. Me interes është të shtojmë se mbeturinat e trungjeve të rrobullit që ndeshen aty-këtu dëshmojnë për ekzistencën e shoqërimin që po përshkruajmë.

Gr. *Vaccinium myrtillus*-*Juniperus nana*

Ky shoqërim është takuar në kundrejtimitet veriore të shpatit lindor të malit, që kanë tokë jo shumë të thellë e të butë, pak gurishtore. Këtu hasen shkurre të rrëguara e mjedis i degraduar nga kullotjet e shumta. Natyrisht më dominantja është *Vaccinium myrtillus*, në tufa të mëdha e me më pak barishtore midis tyre, ndërsa në jastëkë më të vegjël takohet *Juniperus nana*. Shoqërimi duket i varfër në mbulesë, por jo në llojshmëri. Ai përmban një kortezh floristik prej rreth 25 llojesh.

Përfundime

Flora e malit të Valamarës dhe Lenijes është mjaft e pasur dhe e larmishme nisur nga përbërja e terrenit, klima dhe mikroklimat që krijohen, shtrirja gjeografike dhe elemente të tjera që ndikojnë në të. Nga analiza e florës së regjistruar aty shohim se për një periudhë të shkurtër të kryerjes së rlevimeve janë takuar mbi 80 specie bimore, të përfshira në mbi 20 familje e mbi 35 gjini.

Nga kjo sasi llojore takohen rreth 13 lloje reliktesh si *Ostya carpinifolia*, *Caltha palustris*, *Buxus sempervirens* etj., që dëshmon për një florë mjaft të vjetër e të instaluar, 13 mesdhetare si *Ranunculus millefoliatus*, *Koeleria splendens*, *Dianthus sylvestris* etj., 11 ballkanike si *Festuca pançiziana*, *Dianthus minutiflorus* etj.

Kjo florë gjithashtu ka në gjirin e saj lloje me vlera të shumta ekonomike si mjekësore, foragjere, ushqimore, ngjyruese etj. Duhet theksuar se janë përdorur metoda jo të mira të shfrytëzimit të tyre, të cilat sjellin dëmtimin, pakësimin dhe zhdukjen e mjaft prej këyre llojeve.

Bimësia e Valamarës dallohet për një larmi mjaft të madhe të bimësisë: (4 klasa, 4 rende, 4 aleanca, 2 asociacione dhe 5 grupime). Këto sintaksone dallohen për dominim të bishtpelëzës (*Festuca*), e cila jo gjithmonë është element i mirë kullësor, të shoqëruara dhe me disa lloje Leguminosae- sh, që përmirësojnë vlerat kullësore të kullotave.

Literatura

- Adamoviç L. (1907): Die planzengeographisch stellung und gliederung der Balkanhalbiensel. Vienna
- Baldacci A. (1941): La Pinus peuce Gris. O "Molika" degli albanesi, dei montenegrini e dei Bulgari. In: Revista d'Albania. Anno 2. Fasc. 3, 240-260, Milano
- Braun-Blanquet J. (1952): Les groupements vegetaux de la France mediterranea, Montpellier
- Buzo K. (1991): Bimësia e kullotave dhe livadheve të Shqipërisë, Tiranë
- Demiri M. (1983): Flora ekskursioniste e Shqipërisë. Botim i SHBLU. Tiranë
- Dinga L., Hoda P. (2004): Fitogjeografia ;279-280 Tiranë
- Dring J., Hoda P., Mersinllari M., Pignatti S., Mullaj A., Rodwell J., (2002): Plant communities of Albania- a preliminary overview, në Annali di Botanica, vol. II ;7-29.
- Hidmet (1975): Klima e Shqipërisë, 283-290, Tiranë
- Horvat J., Gllavac V., Ellenberg H. (1974): Vegetation sudosteuropas. Stuttgart
- Kabo M. etj. (1991)- Gjeografia Fizike e Shqipërisë, vol. II, fq. 248-254, Tiranë
- Lista e bimëve të rrezikuara në CCE me shkallën IUCN (1997), në State of the Environment in Central and Wostern Europe,- (mars 2001), nga interneti

- Markgraf F. (1975): Die Ubergang der vegetationsstufen Albaniens in die ostliche Balkanhalbinsel In: Problem of Balkan flora and vegetation, faqe 281-285, Sofia
- Markgraf F. (1932): Pflanzengeographie von Albanien. Stuttgart
- Mitrushi I. (1966): Dendroflora e Shqipërisë, Tiranë
- Paparisto et al. (1980-2000): *Flora e Shqipërisë*. (Vol.1-4) Akademia e Shkencave, Tiranë
- Piperi Roland, Kajno Kristaq, (1990): Flora mjekësore e Korçës, Tiranë
- Rodwell J.S., J.H.J Schaminee, Mucina L., Pignatti S., Dring J., Moss D. (2002): The diversity of European Vegetation. Wageningen
- Stevanoviç V., Kit Tan, Jatrou G. (2003): Distribution of the endemic Balkan flora on serpentine I – obligate serpentine endemiks.- Vienna
- Tutin T.G. etj. (1964-1980): *Flora europaea*, vol. 1-5, Cembridge
- Vangjeli J. (1982): Studim gjeobotanik i rrobullit *Pinus heldreichii* Crist ssp. *Leucodermis*(Antoine) Markgraf në Shqipëri (disertacion).
- Qendra Kombetare e Lëvizjes Ambientaliste (2007): Libri i Kuq i Florës shqiptare, Tiranë
- Vangjeli J. (2003): Udhëheqës fushor i florës së Shqipërisë, Tiranë